

## Planprogrami mësimor për lëndën: Kundërvajtjet në Lëmin Penal

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Kundërvajtjet në Lëmin Penal
Niveli:	Studime themelore
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti II, semestri IV (veror)
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	
Koha / lokacioni: Viti akademik	E martë, ora: 09:00 – 11:00, Amfiteatri nr. 2. 2016/2017
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Bajram Ukaj, prof.asc.
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:bajramukaj@hotmail.com">bajramukaj@hotmail.com</a> ; <a href="mailto:bajram.ukaj@uni-pr.edu">bajram.ukaj@uni-pr.edu</a> ;
Përshkrimi i lëndës	Lënda: Kundërvajtjet në lëmin penal përmbanë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hyrje në të drejtën kundërvajtëse në lëmin penal (nacioni, lënda dhe funksioni i saj);</li> <li>- Kuptimi i së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal;</li> <li>- Njohuri të përgjithshme për legjislacionin kundërvajtës;</li> <li>- Nocioni i veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë kundërvajtëse;</li> <li>- Nocioni, funksioni dhe sistemi i sanksioneve kundërvajtëse.</li> </ul>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i studimit të kësaj disipline juridike, ligjore dhe aktuale është që studentëve të studimeve pasdiplomike, t'u ofrojë njohuri thelbësore të mjaftueshme dhe aktuale lidhur me parimet dhe institutet themelore të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><b>Pas përfundimit të studimit të kësaj lënde, pritët që studentët:</b></p> <p>Të kuptojnë se fenomenit dinamik e kompleks të kriminalitetit, pra edhe të kundërvajtjeve në lëmin penale, si formë specifike e kriminalitetit kësaj të keqe të madhe që po e përcjell shoqërinë bashkëkohëse në vazhdimësi, mund t'i kundërvihemi me sukses me masa preventive dhe represive adekuate. Njëra nga masat më të avancuara për luftimin e kësaj dukurie të përditshme negative, është edhe hulumtimi shkencor dhe praktik i kësaj dukurie negative.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të formojnë konceptin se shtimi i</li> </ul>

vazhdueshëm i këtij kriminaliteti të posaçëm – kundërvajtjet në lëmin penal, përhapja e disa formave të rrezikshme të sjelljeve kriminale, si kriminaliteti kundërvajtës në sigurinë e trafikut publik, në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, në lëmin e pylltarisë, bujqësisë, shëndetësisë, ekonomisë, doganave, administratës, arsimit e veprimtarive tjera në fusha të ndryshme, gjithnjë e më shumë aktualizon nevojën për thellimin e studimeve rreth njohjes së shkaqeve dhe rrethanave që kushtëzojnë këtë fenomen negativ për çdo shoqëri.

- Të vetëdijësohen se, sistemi i tërësishëm juridik i vendit, të drejtës kundërvajtëse në lëmin penal si disiplinë juridike pozitive, por edhe si disiplinë shkencore juridike, i takon vend i veçantë në studimin e veprave kundërvajtëse në lëmin penal si formë specifike e kriminalitetit, në parandalimin dhe luftimin e tij, pra në studimin e veprës kundërvajtëse, përgjegjësisë kundërvajtëse të kryerësit të veprës kundërvajtëse, kryerësit të veprës kundërvajtëse, sanksionet kundërvajtëse, procedurën kundërvajtëse, ekzekutimin e vendimeve kundërvajtëse, dhe institutet tjera juridike materiale procedurale dhe ekzekutuese kundërvajtëse. Njëherit, kësaj discipline juridike pozitive i takon vend i veçantë në mbrojtjen e të drejtave të lirive të njeriut, rendit publik dhe qytetarëve të shoqërisë.

- Të formësojnë bindjen se, vepra kundërvajtëse, përgjegjësia kundërvajtëse dhe sanksionet kundërvajtëse në lëmin penal janë institute me aktualitet të mprehtë për tërë Europën, për regjionin, por edhe për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj. Për t'iu bashkangjitur me dinjitet dhe me të drejta të plota Evropës së qytetëruar, është mëse e domosdoshme se këto institute dhe çështje tjera nga fusha e së drejtës kundërvajtëse të studiohen thellësisht, të jepen interpretime dhe zgjidhje që i afrohen më tepër frymës së të drejtës dhe që përputhen me parimin e sundimit të së drejtës (Parimi i ligjshmërisë, parimi i barazisë së qytetarëve para ligjit, parimi i fajësisë personale – i përgjegjshmërisë individuale, parimi i drejtësisë dhe i karakterit subsidiar dhe fragmentar i funksionimit të së drejtës kundërvajtëse dhe me parimet e së drejtës penale dhe penale ndërkombëtare, parime këto të inkorporuara në tërë materien e së drejtës kundërvajtëse), respektivisht jetësimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe shtimin e aktiviteteve të shumta mbarëshoqërore për luftimin e kriminalitetit.

- Të kuptojnë të drejtën kundërvajtëse në lëmin penal si disiplinë pozitive e së drejtës, e cila ka për objekt studimi dispozitat penale të përmbajtura në Ligjin për kundërvajtje, në ligjet tjera dhe në aktet tjera nënligjore të vendit, me qëllim që këto dispozita të bëhen më të qarta, më të kuptueshme, me efekt të zbatimit më të lehtë në praktikën

	<p>gjqësore kundërvajtëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të vërtetojnë faktin se, e drejta kundërvajtëse në lëmin penal nuk studion vetëm institutet e së drejtës kundërvajtëse <i>de lege lata</i>, por edhe <i>de lege ferenda</i>.</li> <li>• Të kuptojnë të dhënë se në kuadër të ligjëratave, ushtrimeve, prezentimeve, debateve, punës me grupe, punimeve seminarike me shkrim dhe shqyrtimeve të rasteve konkrete nga praktika gjyqësore, studentët do të marrin njohuri të shumta rreth: lëndës, funksionit, detyrës dhe specifikave të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal si disiplinë juridike pozitive dhe si shkencë juridike, raporteve të kësaj discipline me disiplinat dhe shkencat tjera juridike, historikun e saj, burimet e së drejtës kundërvajtëse, interpretimin e dispozitave juridike-kundërvajtëse, veprën kundërvajtëse dhe elementet themelore të saj, objektin, subjektin dhe figurën e veprës kundërvajtëse, përgjegjësinë kundërvajtëse (përgjegjshmërinë dhe fajësinë), sanksionet kundërvajtëse (llojet e tyre) delikuencën e të miturve, bazat e përgjithshme të shuarjes së sanksioneve kundërvajtëse, procedurën kundërvajtëse, grupet e veçanta të veprave kundërvajtëse dhe çështjet e tjera nga fusha e së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal.</li> </ul> <p>E drejta kundërvajtëse në lëmin penal është disiplinë juridike dhe shkencore që mësohet në shumë fakultete juridike të regjionit, të Europës dhe botës, qoftë si disiplinë e pavarur juridike ose edhe si pjesë e disiplinave të tjera juridike, dhe njohuritë që merren nga e drejta kundërvajtëse në lëmin penal, paraqesin një bazë të mirë për të lehtësuar nxënien e njohurive në disiplinat tjera juridike, por edhe bazë e mirë për t'u përballur me sfidat e kohës rreth zgjidhjeve të shumë situatave që imponon jeta dhe praktika gjyqësore.</p>
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	javë	2
Ushtrime teorike/laboratorike	/	javë	/
Punë praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	javë	2
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,seminare	2	javë	2
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	/	/	/

Përgaditja përfundimtare për provim	2	javë	2
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	javë	1
Projektet,prezentimet ,etj	2	javë	2
<b>Totali</b>	<b>15</b>	<b>javë</b>	<b>15</b>

<p><b>Metodologjia e mësimdhënies:</b></p>	<p>Gjatë ligjërimit të lëndës E Drejta kundërvajtëse në lëmin penal, do të përdoren metodat bashkëkohëse të mësimdhënies, me qëllim që kjo disiplinë e së drejtës të bëhet më e kapshme, më interesante dhe më e qartë për studentët, dhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Metoda e mësimdhënies aktive.</b> Në mbështetje të kësaj metode shpjegohen, përkufizohen nocionet mbi institutet themelore të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal, interpretimi i drejtë dhe i qartë i tyre, e sidomos duke veçuar rëndësinë e jetësimit të parimeve dhe dispozitave tjera në të cilat mbështetet e drejta kundërvajtëse në lëmin penal në realitetin aktual.</li> <li>• <b>Metoda e mësimdhënies inter-aktive.</b> Zhvillimi i hovshëm i shoqërisë së sotme, si dhe rrita me ritme marramendëse e informacionit, i ndihmuar nga mjetet e shumëllojshme të transmetimit e komunikimit masiv, kanë bërë të mundur që mësimdhënien të ndryshojë në mënyrë rapide . Pra, mësimdhëniesi nuk është më burim i vetëm informacioni. Tani, ai është dhe duhet të jetë një udhëheqës dhe menagjuer i mirë i procesit mësimor që drejton studentin për të hulumtuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe me ndihmën e tij të zgjidhë çdo problem, pa marrë parasysh ndërlikueshmërinë e tij. Meqenëse, në qendër të studimeve është dhe duhet të jetë studenti , atëherë mësimdhëniesi i mbetet të aktivizoj studentin në dhënien e përkufizimeve dhe interpretimeve të parimeve kryesore dhe instituteve themelore të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal. Kjo metodë ka për qëllim t`iu mundësoj studentëve që gjatë studimeve të jenë autonom në punën e tyre dhe të kuptojnë se institutet themelore të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal, jo vetëm që janë fenomene juridike, por janë edhe dukuri sociale – ngjarje që ndodhin në jetën e përditshme.</li> <li>• <b>Metoda krahasuese.</b> Kjo metodë u mundëson studentëve njohjen dhe krahasimin e instituteve më të rëndësishme të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal dhe të sistemit të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal të vendeve fqinje dhe më gjërë. Kjo metodë ka për qëllim t`i njoftojë studentët edhe me raportin e së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal me të drejtën penale me të drejtë penale</li> </ul>
--	--

ndërkombëtare e në veçanti me institutet: veprimi i ligjeve kundërvajtëse në hapsirë, ekstradimi, e drejta e azilit, vepra kundërvajtëse, përgjegjësia kundërvajtëse dhe sanksionet kundërvajtëse, penale të karakterit shtetëror dhe ndërkombëtar dhe çështje të tjera të përmajtura në ligje, kode, akte ligjore dhe nenligjore të karakterit shtetëror dhe ndërkombëtare ( Ligje kundërvajtëse, Kode penale, Akte tjera nenligjore, Rezoluta, Konventa, Protokole, Statute ndërkombëtare, Deklarata etj. ).

- **Metoda e analizës.** Kjo metodë u mundëson studentëve të kuptuarit më fundamental të instituteve dhe parimeve të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal dhe atë duke e bërë zbërthimin – analizën përmajtësore të dispozitave në të cilat përkufizohen parimet kryesore dhe institutet themelore të së drejtës kundërvajtëse me qëllim të aftësimit të studentëve, që pas përfundimit të studimeve të jenë në gjendje të bëjnë zgjidhjen e çështjeve juridike – kundërvajtëse në lëmin penal jo vetëm në aspektin teorik, por edhe në aspektin praktik në gjyqësinë e vendit.

- **Metoda e studimit të rasteve.** Rëndësi të veçantë gjatë interpretimit dhe shpjegimit të instituteve themelore të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal ka studimi i rasteve të veçanta nga praktika gjyqësore kundërvajtëse. Këtu, studentët njoftohen në mënyrë praktike për punën e ardhshme të tyre, duke analizuar rastet konkrete të vendosura në gjykatat kompetente të vendit për çështje konkrete nga fusha e së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal. Me ndihmën e kësaj metode, institutet e së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal bëhen më të afërta, më interesante për të zgjuar kureshtjen e studentëve për të pasur informacione të majaftueshme rreth parimeve dhe instituteve themelore e së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal.

- Rëndësi të veçantë i kushtohet edhe **Metodës juridike dhe sociologjike** me rastin e studimeve të instituteve juridike kundërvajtëse në lëmin penal të përcaktuara në ligjet dhe në aktet nenligjore si fenomene juridike, por edhe si dukuri sociale që paraqiten në shoqërinë e caktuar.

- Duke u nisur nga e dhëna se, parimet dhe institutet e së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal, kanë historikun e tyre, është me vlerë të veçantë edhe përdorimi i **Metodës historike**, sepse me ndihmën e kësaj metode studiohet historiku i parimeve dhe instituteve të së drejtës kundërvajtëse. Duke përdorur këtë metodë, studentët njoftohen me të dhënën se, parimet dhe institutet themelore të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal, nuk kanë qenë të një shkalle të tashme të përkufizimit, por ky nivel i zhvillimit dhe përkufizimit të tyre është rezultat i një përpjekjeje e punës së vazhdueshme të shkencëtarëve dhe profesionistëve të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penale të një periudhe relativisht të gjatë dhe të mundimshme.

	<p>Sipas planëprogramit mësimor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë, Kundërvajtjet në lëmin penal janë paraparë të ligjërohen me dy orë ligjerata në studime themelore në semestri veror dhe atë si lëndë mesimore zgjedhëse.</p> <p>Sa i përket ligjeratave më lartë u prezentuan metodat të cilat do të përdoren me rastin e ligjërimit të kesaj disipline të së drejtës.</p> <p>Ushtrimet, prezentimet , debatet, punimet seminarike me shkrim, kanë një rëndësi të veçantë për studentët me rastin e nxënies së njohurive rreth parimeve kryesore dhe instituteve themelore të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal. Ushtrimet dhe format tjera të punës, kanë për qëllim thellimin e njohurive të studentëve lidhur me këto parime dhe institute dhe për efekt zbatimin e tyre në praktikën gjyqësore dhe jetësimin e tyre në jetën juridike.</p> <p>Gjatë ushtrimeve dhe formave tjera të punës, studentëve iu parashtrihen pyetje konkrete, ku prej studentëve kërkohet të bëjnë përpjekje për të menduar në mënyrë kritike dhe për të dhënë përgjigje adekuate në çështje konkrete.</p> <p>Mësimdhënësi gjatë udhëheqjes së ushtrimeve dhe formave tjera të punës, duhet të krijoj kushte dhe atmosferë të atillë, që studentët të jenë në gjendje të bëjnë interpretimin e drejtë të normës juridike kundërvajtëse dhe në mënyrë të lirshme, që ata të shprehen me një gjuhë të qartë, precize, koncize dhe pa ekuivoke, dhe së bashku me ta të vijë deri te zgjidhja e saktë e çështjes konkrete- përgjigja e saktë.</p> <p>Gjatë ushtrimeve dhe formave tjera të punës, duhet të krijohet një atmosferë e volitshme për punë, ku studentët duke debatuar, duke shprehë ide dhe mendime vetanake dhe kritike rreth shumë parimëve dhe instituteve të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal, të aftësohen në zbatimin praktik të dispozitave juridike – kundërvajtëse dhe në zgjidhjen e rasteve konkrete të rënda e shpesh të ndërlikauara që paraqiten në jetën e përditshme juridike dhe në praktikën gjyqësore kundërvajtëse.</p> <p>Me ndihmën e ligjeratave, ushtrimeve, prezentimeve, seminarëve, punës në grupe, testeve dhe formave tjera të mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive gjatë gjithë semestrit, studentët aftësohen që në të ardhmën, në mënyrë të pavarur dhe në cilesinë e ekspertit profesional t'i sfidojnë sfidat që paraqiten edhe në fushën e së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal.</p>
<p><b>Metodat e vlerësimit:</b></p>	<p><i>Për vlerësimin definitiv të studentëve nga lënda e Drejta Penale do të marren parasysh format e fitimit të pikëve të shprehura në përqindje si vijon:</i></p>

Vlerësimi intermediar.....	25%
Punimi seminarik i mbrojtur publikisht.....	15%
Prezentimi .....	10%
Vijimi i rregullt dhe pjesëmarrja aktive.....	5%
Provimi final.....	45%
<b>Totali.....</b>	<b>100%</b>

**Përshkrimi i sistemit të notimit:**

<b>Nota</b>	<b>ECTS nota</b>	<b>Pike</b>	<b>Përkufizimi</b>
10	A	91–100 %	<b>SHKËLQYESHËM</b> - njohuri të shkëlq.me vetëm disa gabime minore
9	B	81 – 90 %	<b>SHUMË MIRË</b> – mbi mesatare standarde,por me disa gabime
8	C	71 – 80 %	<b>MIRË</b> – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen
7	D	61 – 70 %	<b>KËNAQSHËM</b> – mire,por me mjaft gabime
6	E	51 – 60 %	<b>MJAFTON</b> – rezultatet plotësojnë kriteret minimale
5*	FX	40 – 50 %	<b>DOBËT</b> – kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kreditë
5	F	00 - 39 %	<b>DOBËT</b> – kërkohet shumë punë për të fituar kredi

• **Literatura**

Ligji për kundërvajtje i Kosovës, Prishtinë, 1979.  
 Projektligji për kundërvajtje i Kosovës, Prishtinë 2015.  
 Kodi i Penal i Kosovës, Prishtinë 2013.  
 Kodi i Procedurës Penale të Kosovës 2013.  
 Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale të Kosovës, Prishtinë, 2010.  
 Ligji i të drejtave për të mitur i Maqedonisë, Shkup, 2006\_.  
 Kodi I Drejtësisë për të miturve i Kosovës, Prishtinë, 2010.  
 Dr. Ismet Elezi, Dr. Skënder Kaçupi, Dr. Maksim Haxhia, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1999.  
 Halim Ismajli, Artan Hoxha dhe Ilir Panda, Procedura penale – Komentar, Tiranë, 2004.  
 Dr.Bajram Ukaj, Dënimet në të drejten penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006.  
 Dr. Ejup Sahiti dhe Ismail Zejneli, E drejta e procedurës penale, Shkup, 1998  
 Dr. Ismet Salihu, E drejta Penale - Pjesa e përgjithshme

	<p>Prishtinë 2014.</p> <p>Dr. Ismet Elezi , E drejta penale – Pjesa e posaçme , Tiranë 2009.</p> <p>Dr. Franjo Bacic, Kazнено pravo – Opci dio, Zagreb 1998.</p> <p>Dr. Vlado Kambovski, E drejta penale – Pjesa e përgjithshme, Shkup 2010.</p> <p>Agim Gjoleka dhe Esmeralda Gjoleka, Manuel i mbajtjes së akteve procedurale penale, Tiranë 2001.</p> <p>Ligjet positive, Rregullore dhe aktet nënligjore në të cilat janë të përmbajtura kundërvajtjet në lëmin penal</p>
<b>Plani i dizajnuar i mësimimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimi, lënda dhe funksioni i së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal;</li> <li>- Detyra, sistemi dhe raportet e së drejtës kundërvajtëse me disiplinat tjera të së drejtës;</li> <li>- Burimet e së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal;</li> <li>- Interpretimi i normave kundërvajtëse në lëmin penal.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Ligjërata të autorizuara të mësimdhënësit.</p>
<b>Java e dytë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjshmëria e caktimit të kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për kundërvajtje;</li> <li>- Hapsira e vlefshmërisë së dispozitave ligjore dhe nënligjore për kundërvajtje;</li> <li>- Nocioni i kundërvajtjes (përkufizimi dhe elementet themelore të kundërvajtjes në lëmin penal;</li> <li>- Figura e veprës kundërvajtëse në lëmin penal.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Ligjërata të autorizuara të mësimdhënësit.</p>
<b>Java e tretë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objekti dhe subjekti i veprës kundërvajtëse.</li> <li>- Përgjegjësia për kundërvajtje.</li> <li>- Fajësia për kundërvajtje (dashja dhe pakujdesia).</li> <li>- Bazat të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë dhe fajsinë në lëmin e kundërvajtjeve.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fazat e kryerjes së veprës kundërvajtëse</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Ligjërata të autorizuara të mësimdhënësit.</p>
<b>Java e katërt:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunimi në kundërvajtje;</li> <li>- Mënyra, vendi dhe koha e kryerjes së veprës kundërvajtëse;</li> <li>- Sanksionet kundërvajtëse (nocioni dhe elementet e tyre);</li> <li>- Dënimet kundërvajtëse ( dënimi me gjobë dhe dënime tjera).</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Ligjërata të autorizuara të mësimdhënësit.</p>
<b>Java e pestë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Masat mbrojtëse në kundërvajtje;</li> <li>- Masat educative;</li> <li>- Parashkrimi i kundërvajtjeve në lëmin penal dhe llojet e tij.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Ligjërata të autorizuara të mësimdhënësit.</p>
<b>Java e gjashtë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Organet për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse;</li> <li>- Fillimi i procedurës kundërvajtëse;</li> <li>- Kompetenca reale dhe territoriale;</li> <li>- I pandehuri dhe i demtuari në procedurën kundërvajtëse.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Dispozitat përkatëse të Ligjit për kundërvajtje.</p>
<b>Java e shtatë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Parashkrimet dhe procesverbalet.</li> <li>- Afatet e udhëheqjes së procedurës kundërvajtëse.</li> <li>- Kthimi në gjendjen e mëparshme.</li> <li>- Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse.</li> <li>- Kërkesa pasurore juridike.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Dispozitat përkatëse të Ligjit për kundërvajtje</p>
<b>Java e tetë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrja e vendimeve dhe komunikimi i tyre;</li> <li>- Dërgimi i shkresave;</li> <li>- Fillimi dhe rrjedha e procedurës kundërvajtëse;</li> <li>- Shqyrtimi gjyqësor</li> <li>- Aktvendimi për kundërvajtje në lëmin penal.</li> </ul>

	<p><b>Literatura:</b> Dispozitat përkatëse të Ligjit për kundërvajtje.</p>
<b>Java e nëntë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjetet e rregullta juridike dhe të jashtëzakonshme në procedurën kundërvajtëse.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Dispozitat përkatëse të Ligjit për kundërvajtje</p>
<b>Java e dhjetë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Procedura kundërvajtëse ndaj të miturve;</li> <li>- Kompenzimi i dëmit për shkak të ndëshkimit të padrejtë për kundërvajtje.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Dispozitat përkatëse të Ligjit për kundërvajtje</p>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzekutimi i aktvendimit për kundërvajtje;</li> <li>- Parimet e ekzekutimit të kundërvajtjeve në lëmin penal;</li> <li>- Sistemet e ekzekutimit.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Dispozitat përkatëse të Ligjit për kundërvajtje.</p>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimi, lënda dhe sistemimi i pjesës së posaçme të së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal;</li> <li>- Veprat kundërvajtëse në lëmin e rendit dhe qetësisë publike.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Dispozitat përkatëse të Ligjit për kundërvajtje.</p>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Veprat kundërvajtëse në lëmin e sigurisë në trafikun publik (karakteristikat, format e kryerjes së këtyre veprave).</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Ligji mbi sigurinë në trafikun publik</p>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Veprat kundërvajtëse në lëmin e ekonomisë;</li> <li>- Veprat kundërvajtëse në lëmin e financave.</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Ligjet përkatëse mbi fushat e cekura më lartë.</p>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<p><b>Ligjerata: Dy orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Veprat kundërvajtëse në fushat tjera të së drejtës.</li> </ul>

	<b>Literatura:</b> Ligjet përkatëse mbi fushat e cekura më lartë.
--	---

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Ligjërata dhe vlerësimi në pajtim me orarin dhe informatën për studentë;</li><li>- Sjellja në pajtim me rregulloren e fakultetit.</li></ul>